



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1089/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Fadil Gashi anëtar kandidat për asamble kuvendit komunal nga rradhët e Partisë së Drejtësisë (PD-) në Suharekë, paraqitur kundër Bajram Tërshani, për shkak të publikimeve të rezultateve përfundimtare për asamble komunale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Fadil Gashi kandidat për kuvendin komunal në Suharekë nga rradhët e subjekti politik Partia e Drejtësisë (LB).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Fadil Gashi i subjektit politik Partia e Drejtësisë (PD), i cili thekson se është i pakënaqur gjatë zgjedhjes së komisionereve ku zgjedhja e tyre sipas tij është bërë pa pëlqimin e anëtarëve të kryesisë si dhe në raundin e dytë të zgjedhjeve ndërrimi i tyre është bërë pa dijen e anëtarëve të kryesisë theksohet në ankesë e tij.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesit Fadil Gashi nga komuna e Suharekës i cili është i pakënaqur me zgjedhjen e anëtarëve të komisionerëve të cilët janë zgjedhur pa pëlqimin e kryesisë. PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj ankesa e tillë është e pa bazuar dhe në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1089/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**

Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetekatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.